

VENDIM
Nr. 380, datë 10.7.2025

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 397, DATË 13.5.2020,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA PROJEKTI ‘NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR UNAZA
LINDORE LOTI 3’, TIRANË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 397, datë 13.5.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) në pikën 3, vlera “...1 231 857 207.57 (një miliard e dyqind e tridhjetë e një milionë e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e shtatë pikë pesëdhjetë e shtatë) lekë...” zëvendësohet me “...1 240 379 782.17 (një miliard e dyqind e dyzet milionë e treqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e dy pikë shtatëmbëdhjetë) lekë...”;

b) në pikën 4, vlera “...1 231 857 207.57 (një miliard e dyqind e tridhjetë e një milionë e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e shtatë pikë pesëdhjetë e shtatë) lekë...” zëvendësohet me “...1 240 379 782.17 (një miliard e dyqind e dyzet milionë e treqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e dy pikë shtatëmbëdhjetë) lekë...”;

c) pas pikës 4/1 shtohet pika 4/2, me këtë përmbajtje:

“4/2. Vlera shtesë, prej 8 522 574.60 (tetë milionë e pesëqind e njëzet e dy mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër pikë gjashtëdhjetë) lekësh, përballohet nga buxheti i shtetit, llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.”.

2. Shpenzimet procedurale shtesë, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

3. Tabelës, bashkëlidhur vendimit nr. 397, datë 13.5.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, i shtohet tabela, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, i pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin.

5. Agjencia Shtetërore për Shpronësimin kryen procedurat për likuidimin e pronarit të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

6. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 1 dhe Drejtoria Vendore Tiranë Jug, dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE PËRFUNDIMTARE PËR PASURINË E PALUAJTSHME PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VKM-në NR. 397, DATË 13.5.2020, 'PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI 'NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR UNAZA LINDORE LOTI 3', TIRANË'', I NDRYSHUAR

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale m ²	ARË			TRUALL			BANESË			NDËRTESE			VLERA TOTALE (lekë)	SHËNIME
								Sip. m ²	Çmimi l/m ²	Vlera lekë/m ²	Sip. (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera (lekë)	Sip.Ndërt. konf. ZVRPP (m ²)	Çmimi mes. sh/blerjeve sipas ZVRPP-së (l/m ²)	Vlera (lekë)	Sip. m ²	Çmimi	Vlera (sipas preventivit)		
1	NAIM	FERID	HOXHA	8170	10/243	TRUALL	140.7				140.7	32878	4625934.6	45.1	86400	3896640				8,522,574.60	
VLERA TOTALE													4,625,935.00			3896640				8,522,574.60	